



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 12, datë 27.02.2025**

**PËR  
MIRATIMIN E RIEMËRIMIT TË Z. AVNI PONARI NË FUNKSIONIN E  
ADMINISTRATORIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT “SIGAL UNIQA GROUP  
AUSTRIA” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 52/2014, “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, të Rregullores nr. 137, datë 21.12.2015 “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të Këshillit të Administrimit/Mbikëqyrës, Administratorit/Anëtarit të Bordit të Drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e riemërimit të z. Avni Ponari, në funksionin e Administratorit të Përgjithshëm të shoqërisë së sigurimit “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a., për një afat 3 (tre) vjeçar deri më datë 24.02.2028.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR  
Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV  
Mimoza KAÇI**